



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:232230

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05435983

**P.nr.1145/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Gani Kastrati, me procesmbajtësen Shureta Ballxhi, në çështjen penale ndaj akuzuarit: **SH. F. K., nga Prizreni rr. “.....” nr. ....**, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181par. 1. të KPRK-së nr. 06/L-074, dhe **F. J., K., nga Prizreni rr. “.....” p.nr. në anën e epërme të transitit afër xhamisë së Millanoviçëve**, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181.par. 1. të KPRK-së nr. 06/L-074 sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 1995-5/23 të dt. 31.10.2023, me dt. 11.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të akuzuarit Sh. K., nga Prizreni dhe F. K., nga Prizreni, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren QN. Ndm.83/24, e datës 05.03.2024.

**II.HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 1995-5/23 të dt. 31.10.2023 dhe

**III.PUSHOHET** procedura penale ndaj të akuzuarve:

**1.SH. K.,** nga i ati F. e ëma ..... e lindur ....., i lindur me dt. ....në Prizren ku dhe tani jeton në rr. “.....” p.nr., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptar shtetas i R. së Kosovës, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181. par. 1. të KPRK-së nr. 06/L-074, dhe

**2.F. K.,** nga i ati J., e ëma .....e lindur K., i lindur me dt. ....në Veles R. e Maqedonisë, tani me vendbanim në Prizren rr. “.....” nr. ..., i divorcuar, me numër personal ....., shqiptar shtetas i R. së Kosovës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181.par.1. të KPRK-së nr. 06/L-074.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr. 1995-5/23 të dt. 31.10.2023, ndaj të pandehurve Sh. K., nga Prizreni rr. “.....” p.nr., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181.par.1. të KPRK-së nr. 06/L-074 dhe F. K., nga Prizreni rr. “.....” nr. ...., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181.par.1. të KPRK-së nr. 06/L-074.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 05.03.2024 në të cilën kanë prezantuar Prokurori i shtetit Labinot Jetishi, dhe të akuzuarit Sh. K., nga Prizreni dhe F. K., nga Prizreni.

Me propozimin dhe pajtimin e palëve – të akuzuarit Sh. K., dhe F. K., të cilët i kanë propozuar gjykatës që këtë çështje ta dërgojë në procedurën e ndërmjetësimit dhe pas dhënies së mendimit dhe pajtimit nga prokurori i shtetit Labinot Jetishi, gjykata me aktvendim pranoj propozimin e palëve në bazë të ligjit për ndërmjetësim dhe KPPRK-së.

Me datë 05.03.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren, është lidhur marrëveshja QN. NDM.nr. 83/24 për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarve Sh. K., nga Prizreni rr. “Çesk Zadeja” p.nr. dhe F. K., nga Prizreni rr. “.....” nr. ....,

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Andaj, duke u bazuar në provat si më lart dhe në bazë të nenit 358, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK dhe nenit 12, par.12.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL**

2023:232230, 11.03.2024

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Gani Kastrati

**KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.**